



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**Spektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

# **STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL**

## **“KOPSHTARI”**

**Niveli III në KSHK<sup>1</sup>, referuar nivelit III të KEK<sup>2</sup>**

**H5-III-19**

Tiranë, Qershor 2019

---

<sup>1</sup> Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

<sup>2</sup> Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“KOPSHTARI”			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	<b>H5-III-19</b>
<b>Qëllimi:</b>	<p>Qëllimi i kualifikimit profesional “Kopshtari” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, është të përgatisë punonjës të kualifikuar për rritjen dhe kultivimin e bimëve zbukuruese, perimeve, bimëve drufrutore (pemë frutore, ullinj e agrume), hardhive dhe barishteve që përdoren për konsum në kuzhinë, për përdorim mjekësor ose dhe kozmetik.</p> <p>Ky kualifikim profesional mundëson rritjen e alternativave për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejtë me kopshtarinë, si dhe zhvillimin e personalitetit të individit për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.</p>			
<b>Kriteret e përgjithshme të pranimit:</b>	<p>Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Kopshtari” të nivelit III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• kanë përfunduar kualifikimin profesional “Bujqësi”, nivelin II në KSHK, referuar nivelit II të KEK,;</li> <li>• janë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.</li> </ul> <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla.</p>			
<b>Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:</b>	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Kopshtari”, III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe Supplementin përkatës, që përkon me nivelin e punonjësit të kualifikuar në këtë fushë profesionale në tregun e punës. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës, <i>brenda dhe jashtë vendit</i>, për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të shërbyer në kopshtet shtëpiake e rezidenciale në zonat urbane dhe rurale;</li> <li>• Në njësi të rritjes dhe shitjes së bimëve të kopshtarisë</li> <li>• Vetëpunësim në kopshtin e shtëpisë ose rezidencës vetjake</li> </ul> <p>Në përfundim të këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK, (teknik/menaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
<b>Data e validimit</b>				
<b>Data e miratimit</b>				
<b>Variantet e mëparshme</b>	<b>H-II-06-14</b>			

# STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

## NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin “Kopshtari” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

### Bazat e kopshtarisë

- Të përshkruajë rëndësinë dhe vlerat ekonomiko-shoqërore dhe sociale të kopshtarisë;
- Të përshkruajë kopshtarinë familjare në zonat rurale dhe urbane, si dhe traditën e vendit tonë në lidhje me zhvillimin e kopshtarisë si aktivitet i rëndësishëm për vetëpunësim, vetëfurnizim dhe për treg;
- Të shpjegojë klasifikimin e kopshteve sipas destinacionit (kopsht perimesh, pemësh frutore, bimësh zbukuruese, aromatike dhe i përzierë) dhe madhësisë së tyre;
- Të listojë llojet e kulturave kopshtare, sipas kushteve klimatiko-tokësore dhe qëllimit ekonomike;
- Të përshkruajë përmbajtjen e një projekti për ngritjen e një kopshti;
- Të përshkruajë pjesët përbërëse (rrugica, rrethimi, bordurat e gjelbërta...etj.) të kopshtit dhe qëllimin e përdorimit të tyre;
- Të përshkruajë kërkesat për klimë, tokë dhe elementë ushqyes të bimëve kopshtare;
- Të shpjegojë rëndësinë e kryerjes së analizave të tokës për përmbajtje të elementëve ushqyes;
- Të listojë llojet e plehrave që i nevojiten tokës në varësi të rezultateve të dala nga analizat e kryera paraprakisht;
- Të përshkruajë masat, për sigurimin e kullimit dhe ujitjes të tokës për kultivimin e kulturave të kopshtit;
- Të përshkruajë llojin dhe përdorimet e veglave, pajisjeve dhe mjeteve të kopshtarisë;
- Të përshkruajë mundësitë e mekanizimit të thjeshtë të proceseve të punës në kopshtari;
- Të rendisë proceset e përgatitjes së tokës (punimet bazë dhe përgatitore) për kultivimin e kulturave kopshtare;
- Të përshkruajë cilësitë fiziko-kimike të materialit mbjellës (farë, fidanë, qepujkë, kalem etj.) që do të mbillen në kopsht;
- Të përshkruajë rëndësinë e renditjes së kulturave kopshtare në përputhje me kërkesat e secilës kulturë;
- Të përshkruajë rëndësinë e kombinimit të bimëve të kopshtit (fruta, perime, bimë dekorative etj.), për shfrytëzimin racional të tokës;
- Të përshkruajë dallimet midis barërave të këqija nga ato të dobishme në kopsht, si dhe masat për mënjanimin e tyre;
- Të përshkruajë sëmundjet dhe dëmtuesit kryesorë, dëmin bujqësor e ekonomik prej tyre;
- Të shpjegojë masat e luftimit (agroteknike, biologjike, integruar dhe kimike) në kulturat e kopshtit ;

- Të shpjegojë nevojën e përzgjedhjes së pesticideve të lejuara për përdorim në kopsht, duke iu përmbajtur rregullave teknike të ruajtjes së shëndetit dhe mjedisit;
- Të përshkruajë teknikën e përpunimit të plehrave organike të stallës dhe kompostimit të mbetjeve bimore të kopshtit;
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të bimëve përmirësuese të pjellorisë së tokës;

### **Krijimi dhe shfrytëzimi i kopshtit familjar**

- Të shpjegojë rëndësinë ekonomike, sociale dhe familjare të krijimit të kopshtit familjar;
- Të përshkruajë rëndësinë e organizimit dhe planifikimit të punës në kopshtarinë familjare;
- Të përshkruajë parcelizimin e ndarjes së tokës për vendosjen e kulturave në kopsht;
- Të përshkruajë punimet bazë dhe ato përgatitore të tokës për mbjellje sipas kulturave (perime, fruta, bimë aromatike etj.);
- Të listojë llojin e plehërimit në përputhje me llojin e kulturës;
- Të përshkruajë llojet e veglave, mjeteve dhe materialeve të domosdoshme në kopsht;
- Të përshkruajë rëndësinë e mirëmbajtjes dhe ruajtjes së veglave, mjeteve dhe materialeve nga dëmtimet atmosferike dhe përdorimi;
- Të përshkruajë rëndësinë e gjendjes fizike dhe vendit për sigurimin e mjeteve dhe veglave;
- Të shpjegojë llojet dhe burimet e bimëve të kopshtit duke marrë parasysh nevojat e familjes;
- Të përshkruajë përdorimin e shfrytëzimin e mjeteve të transportit;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së shëndetit të anëtarëve të familjes, gjatë trajtimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve;
- Të përshkruajë rëndësinë e sigurimit të ujit për ujitje;
- Të përshkruajë rëndësinë e sigurimit të vazhdueshëm të energjisë elektrike për kryerjen e shërbimeve në kopsht e familje;
- Të përshkruajë rëndësinë e mirëmbajtjes dhe dezinfektimit të rezervave ujore;
- Të analizojë shpenzimet e krijimit dhe përdorimit të kopshtit;
- Të përshkruajë mënyrën e dokumentimit të proceseve të punës në kopshtari;

### **Organizimi dhe pajisjet e ekonomisë shtëpiake**

- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit e shpërndarjes funksionale të çdo mjedisi të shtëpisë;
- Të analizojë gjendjen organizative të kopshtit familjar dhe shpenzimet në familje;
- Të përshkruajë burimet financiare dhe mënyra e llogaritjes së tyre;
- Të shpjegojë shkaqet që ndikojnë në madhësinë e buxhetit familjar;
- Të përshkruajë mundësitë e vetë furnizimit në kopshtin familjar;
- Të analizojë rrugët e përdorura për kursim të energjisë, gazit e ujit;
- Të përshkruajë arredimin e mjediseve të veçanta të shtëpisë me bimësi të ndryshme;
- Të listojë shërbimet periodike dhe ditore të bimësisë në mjedise të brendshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e ndarjes së punës në varësi të numrit të pjesëtarëve, gjinisë dhe moshës;
- Të shpjegojë rëndësinë e mirë ushqyerjes në familjen e kopshtarëve sipas kategorive të familjarëve;
- Të përshkruajë kushtet higjieno - sanitare në ekonominë familjare;
- Të shpjegojë rëndësinë e sigurimit të shëndetit të familjarëve;

- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes së ndihmës së shpejtë në familje;
- Të listojë llojet e bimëve mjekësore, si dhe përdorimet e tyre në familje;

### **Bimët zbukuruese dhe eterovajore**

- Të përshkruajë rëndësinë, rolin dhe vlerat e bimëve zbukuruese në mjedis dhe jetën e njeriut;
- Të argumentojë vlerën ekonomike dhe estetike të prodhimit të bimëve zbukuruese;
- Të klasifikojë bimët zbukuruese sipas jetëgjatësisë, mënyrës së shtimit dhe përdorimit të tyre, sipas zonave klimatike;
- Të përshkruajë përgatitjen e tokës, mbjelljen, shërbimet agro-teknologjike të bimëve zbukuruese, sipas periudhave të kultivimit;
- Të përshkruajë kultivimin dhe llojet kryesore të bimëve zbukuruese barishtore (një, dy dhe shumëvjeçare), karakteristikat dhe mënyrat e rritjes të tyre;
- Të përshkruajë kultivimin dhe llojet kryesore të bimëve zbukuruese qepore, zhardhokore dhe rizomatore, si dhe karakteristikat e mënyrat e rritjes të tyre;
- Të përshkruajë kultivimin dhe llojet kryesore të bimëve zbukuruese shkurre, karakteristikat dhe mënyrat e rritjes të tyre;
- Të përshkruajë kultivimin dhe llojet kryesore të drurëve zbukurues gjethore dhe halore, si dhe karakteristikat dhe mënyrat e rritjes të tyre;
- Të përshkruajë bimët zbukuruese të destinuar për prerje (karafili, trëndafili, gardenia etj.);
- Të përshkruajë llojet, karakteristikat dhe mënyrat e rritjes së bimëve zbukuruese për ambiente të brendshme;
- Të përshkruajë rolin dhe elementët përbërës të hapësirave të gjelbra, si dhe kombinimet e bimëve zbukuruese me barin në këto hapësira;
- Të shpjegojë hapat për ndërtimin e projekteve të thjeshta për krijimin e hapësirave të gjelbra, sipas qëllimit të shfrytëzimit të tyre;
- Të përshkruajë shërbimet që kryhen për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, si dhe masat mbrojtëse të shkurreve e pemëve dekorative ndaj sëmundjeve e dëmtuesve të tyre;
- Të përshkruajë rëndësinë, vlerat ekonomike dhe shëndetësore të bimëve eterovajore;
- Të përshkruajë llojet më të përhapura dhe mënyrat e kultivimit të bimëve eterovajore;
- Të klasifikojë bimët eterovajore kryesore sipas përdorimit të tyre në farmaceutikë, kozmetikë dhe për erëza;

### **Agroturizmi në familje**

- Të përshkruajë shërbimet e ofruara nga agroturizmi familjar në varësi të zonave klimatike të vendit tonë;
- Të listojë kushtet që duhet të plotësojë një zonë për zhvillimin e agroturizmit familjar;
- Të përshkruajë organizimin shtëpiak në funksion të shërbimit agroturistik;
- Të përshkruajë llojet e produkteve dhe shërbimeve të ofruara në agroturizëm;
- Të theksojë rëndësinë dhe rolin e plotësimit të kushteve higjieno-sanitare të mjediseve të familjeve bujqësore për agroturizëm;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit (mikpritja) me turistët për jetesën, traditën, veshjen, ushqimin etj.;

- Të përshkruajë mënyrat e nxitjes së interesit të klientit turistik për produktet agroturistike (shitja ose dhurimi tek dera e shtëpisë);
- Të shpjegojë rëndësinë e krijimit të hapësirave në mjedisin përreth shtëpisë për organizimin e aktiviteteve familjare;
- Të përshkruajë organizimin e aktiviteteve të prodhimit të produkteve ushqimore në prani të turistëve duke nxitur edhe pjesëmarrjen e tyre;
- Të shpjegojë rolin që luan agrobiznesi në zhvillimin e turizmit familjar;
- Të shpjegojë rolin e burimeve natyrore si ( peizazhi natyror, biodiversiteti i florës dhe faunës, ujërave etj.) për zhvillimin e agroturizmit familjar;
- Të shpjegojë rolin e larmisë klimatike, si burim për zhvillimin gjithëvjeter të agroturizmit familjar;
- Të shpjegojë rëndësinë e ruajtjes së traditës në veshje, zakone dhe ushqim tradicional për qëllime turistike;

### **Perimet dhe bimët e arave**

- Të klasifikojë perimet e kopshtit sipas qëllimit për të cilat kultivohen (frutor, frutrrënjor, gjethore, gjethore- kërcellore, lulore, bishtajore etj.);
- Të shpjegojë kultivimin e perimeve, sipas qëllimit të kultivimit, në kushtet e kopshtit;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të hershëm ,të mesëm, të vonë të perimeve solanore (domate, spec, patëllxhan) ;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të qepës me qepujka ,fidan ;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të qepës së njomë me qepujka dhe fidanë;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të preshit me fidanë, si dhe specifikat e prodhimit, vjeljes e magazinimit;
- Të përshkruajë agroteknologjinë e prodhimit të hudhrës me thelpinj, si dhe specifikat e prodhimit, vjeljes dhe magazinimit;
- Të shpjegojë veçoritë e agroteknologjisë së kultivimit të perimeve bostanore (kastravec, shalqi, pjepër, kungull) në sera dhe në fushë;
- Të shpjegojë specifikat e agroteknologjisë së prodhimit të lakrës ,lulelakrës me fidanë;
- Të shpjegojë agroteknologjinë e prodhimit të spinaqit, pazisë, lëpjetës për prodhim gjethor
- Të përshkruajë momentet e vjeljes së perimeve të kopshtit për konsum të freskët ;
- Të shpjegojë teknologjinë e kultivimit të patates për prodhim të hershëm, mesëm dhe të vonë, sipas zonave klimatike dhe llojit të tokës;
- Të përshkruajë teknologjinë e kultivimit të misrit të ëmbël për gatim;
- Të shpjegojë teknologjinë e kultivimit të lulediellit dhe kikirikut për fara;
- Të shpjegojë teknologjinë e kultivimit dhe prodhimit të kërpudhave të ngrëshme në kushtet e kopshtit;
- Të përshkruajë mënyrat e ambalazhimit dhe teknikat e ruajtjes së prodhimit në kushte familjare;

### **Frutat e kopshtit**

- Të shpjegojë vendosjen estetike të drurëve frutorë dhe hardhisë;

- Të listojë llojet dhe kultivarët e pemëve frutore farore, bërthamore, agrumet, arrore, etj. në përputhje me kushtet klimatiko-tokësore të zonës;
- Të listojë llojet e kultivarët e pemëve shkurrore dhe gjysmë shkurrore, dhe mënyrën e vendosjes së tyre në bllokun e pemëtores së kopshtit;
- Të përshkruajë rëndësinë ekonomike të kultivimit të frutave të vogla (luleshtrydhe, mjedra, boronica, manaferra,... etj.);
- Të përshkruajë mënyrat e kultivimit, procesin e vjeljes dhe të ruajtjes së frutave të vegjël;
- Të përcaktojë kultivarët e hardhisë për rrush në varësi të qëllimit të kultivimit (tavolinë, përpunim, treg);
- Të rendisë mënyrat e përgatitjes së tokës, mbjelljes, si dhe shërbimeve agroteknike (ujitje, prashitje, plehërim, krasitje, etj.) në pemët e mbjella në kopsht;
- Të argumentojë rëndësinë estetike dhe produktive të llojeve të krasitjes në pemët e kopshtit;
- Të shpjegojë mënyrat e vjeljeve, ruajtjes dhe ambalazhimit të prodhimit të destinuar për treg;

### **Kafshët e prodhimit dhe shërbimit në kopshtari**

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e mbajtjes së kafshëve shtëpiake sipas zonave dhe nevojave të familje;
- Të shpjegojë rëndësinë e të ushqyerit dhe mirëqenies së kafshëve dhe shpendëve në kopshtin familjarë;
- Të përshkruajë teknikat e përpilimit të një racioni ushqimor për kafshët dhe shpendët;
- Të përshkruajë të ushqyerit e kafshëve, të imëtave sipas kategorive;
- Të shpjegojë teknologjinë e të ushqyerit të gjedhit sipas fazave fiziologjike;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të kalit si transportues dhe sporte të ndryshme;
- Të shpjegojë teknologjinë e të ushqyerit kalit për transport dhe sporte të ndryshme;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbajtjes dhe të ushqyerit e qeneve dhe maceve në shtëpi;

### **Bazat e sipërmarrjes në kopshtari**

- Të shpjegojë bazat e ekonomisë së tregut familjar;
- Të shpjegojë subjektet ekonomike dhe veprimtarinë e tyre;
- Të shpjegojë organizimin e punës dhe drejtimin e një ekonomie familjare;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të përshkruajë legjislacionin në fuqi për aktivitetin e kopshtarisë në zonat urbane, nën-urbane, rurale dhe turistike;
- Të përshkruajë karakteristikat e konsumatorëve (familja, turistët etj.) të produkteve të kopshtit;
- Të listojë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në ngritjen e një kopshti familjar;
- Të shpjegojë marketingun e prodhimeve dhe shërbimeve të kopshtarisë;
- Të shpjegojë rëndësinë e shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve të kopshtarisë;
- Të shpjegojë rëndësinë e hartimit të kontratave të shit-blerjes për produktet e kopshtarisë;
- Të shpjegojë kuptimin e bankave, institucioneve financiare dhe shërbimet e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të thjeshta ekonomike që lidhen me prodhimin dhe tregtimin e produkteve të kopshtarisë;

- Të analizojë kostot e prodhimit dhe shërbimeve në kopshtari;
- Të shpjegojë llogaritjen e çmimeve të produkteve të kopshtarisë duke u bazuar në kosto;
- Të përshkruajë nocionin e të ardhurave dhe shpenzimeve për ekonominë familjare;
- Të interpretojë dokumentacionin financiar dhe teknik për punimet në kopsht;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;

#### **Sigurimi teknik, dhe mbrojtja e mjedisit**

- Të listojë rregullat e përdorimit të pesticideve në aktivitetin e mbrojtjes së bimëve të mbjella në kopsht;
- Të listojë rregullat e sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve shtëpiake dhe mjedisit;
- Të listojë rregullat e sigurimit teknik në punë e të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve në kopshtari;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me energjinë elektrike;

#### **Legjislacioni në kopshtari**

- Të listojë aktet ligjore e normative, që rregullojnë veprimtarinë në kopshtari;
- Të përshkruajë aktet ligjore dhe normative në fuqi për prodhimtari dhe tregtim e produkteve në kopshtar;
- Të rendisë procedurat e certifikimit të materialeve të shumimit;
- Të përshkruajë normativat bazë ligjore për konkurrencën në treg për produktet;
- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij;
- Të përshkruajë elementet bazë të legjislacionit të pronësisë;

## **SHPREHI PROFESIONALE**

Individi duhet të jetë i aftë:

#### **Kopshtaria**

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të ruajë dhe pastrojë mjedisin e punës;
- Të krijojë skica për ngritjen e një kopshti të thjeshtë në përputhje me sipërfaqen;
- Të përzgjedhë veglat, mjetet dhe materialet e nevojshme të punës në kopshtari, sipas procesit të punës që do të kryhet;
- Të pastrojë nga gurët dhe mjetet e forta si dhe të sistemojë vendin për ngritjen e kopshtit familjar;
- Të kryejë punime bazë të tokës shoqëruar me plehërim organik për ngritjen e kopshtit familjarë;
- Të kryejë punime përgatitore (frezimin, nivelimin, plehërim fosforik, etj.) për ngritjen e kopshtit familjar;
- Të zbatojë skemën e qarkullimit të kulturave kopshtare, për ruajtjen e pjellorisë së tokës;



- Të zbatojë modele të thjeshta kopshtesh në përputhje me sipërfaqen e tokës në dispozicion;
- Të kryejë mbjelljen e luleve dhe bimëve një dhe shumë vjeçare sipas skicave të ndërtuara në harmoni me njëra-tjetrën dhe madhësinë e rritjes së tyre;
- Të kryejë shërbimet agroteknike në kushtet e një ekonomie kopshtare;
- Të përdorë, sipas qëllimit, të gjitha pjesët përbërëse e ndihmëse të kopshtit;
- Të përpunojë plehrat e stallës dhe kompostojë mbetje organike bimore;
- Të kultivojë e përmbysë në tokë bimët përmirësuese të pjellorisë dhe përbërjes mekanike të tokës (bishtajore farogjere);
- Të përdorë ushqime të helmuara për luftimin e dëmtuesve të tokës;
- Të sigurojë pajisjet e nevojshme për rritjen dhe mbrojtjen e kulturave të kopshtarisë kundër rreziqeve klimaterike (breshër, ngrica, thatësirë etj.);
- Të kryejë përshtatje apo riparime të vogla të mjeteve, pajisjeve apo sistemeve;
- Të përdorë mjetet personale mbrojtëse gjatë operacioneve të ndryshme të punës;
- Të kujdeset për shëndetin e bimëve kopshtare nëpërmjet masave parandaluese (hapje kanalesh, lyerje me gëlqere, ngritje gardhesh, mbledhje të gjetheve dhe degëve të thara etj.);
- Të kryejë trajtime kundër sëmundjeve, dëmtuesve dhe barërave të këqija në bimët e kopshtit;

#### **Perimet dhe bimët e arave**

- Të përzgjedhë perimet e kopshtit sipas qëllimit (frutor, frutrrënjor, gjethore, gjethore-kërcellore, lulore, bishtajore etj.) ;
- Të kultivojë perimeve solanore (domate, spec, patëllxhan) ;
- Të kultivojë qepë të thatë me qepujka ,fidan ;
- Të kultivojë qepë të njomë me qepujka dhe fidanë;
- Të kultivojë presh me fidanë ;
- Të kryejë prodhimin e hudhrës me thelpinj ;
- Të kultivojë perime bostanore (kastravec, shalqi, pjepër, kungull) në sera dhe në fushë;
- Të kryejë kultivimin e lakrës ,lulelakrës me fidanë;
- Të kryejë kultivimin e spinaqit, pazisë, lëpjetës për prodhim gjethor
- Të kryejë vjeljen e perimeve të kopshtit për konsum të freskët ;
- Të kryejë kultivimin e patates për prodhim të hershëm, mesëm dhe të vonë,
- Të kryejë kultivimin të misrit të ëmbël për gatim;
- Të kryejë kultivimin e lulediellit dhe kikirikut për fara;
- Të kryejë kultivimin dhe prodhimin të kërpudhave të ngrënshme në kushtet e kopshtit;
- Të ambalazhimit dhe ruajtjen prodhimin në kushte familjare;

#### **Frutat e kopshtit**

- Të përzgjedhë kultivarët e pemëve frutore farore, bërthamore, arrorëve ,agrumëve, ullinjve dhe hardhisë etj.;
- Të kryejë përgatitjen dhe plehërimin e tokës për mbjelljen pemëve frutorë, ullinjve, agrumëve dhe hardhisë;
- Të kryejë mbjelljen estetike të drurëve frutorë, ullinjve, agrumëve dhe hardhisë;

- Të kryejë shërbimet gjatë vegetacionit në drufrutorë, ullinjve, agrumeve dhe hardhi ;
- Të kryejë kultivimin e frutave të vogla (luleshtrydhe, mjedra, boronica, manaferra, etj.);
- Të kryejë vjeljen, ruajtjen dhe ambalazhimin të frutave të destinuar për treg dhe nevojat e familjes;

### **Bimët dekorative dhe aromatike**

- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik të ruajë dhe pastrojë mjedisin rrethues;
- Të përzgjedhë mjetet dhe pajisjet e nevojshme për mbjelljen e luleve;
- Të përdorë të gjitha llojet e vazove, por edhe mjetet rrethanore për mbjelljen e bimëve dekorative në kushtet e shtëpisë si poçe të thyera balte apo qelqi, karroca, goma, trungje etj.;
- Të përgatisë dherishten për mbushjen e enëve për mbjelljen e bimëve zbukuruese;
- Të realizojë mbjelljen e bimëve në mjedise të brendshme të shtëpisë si (zamia, palma bambu, luleshpata, zambaku i paqes, drancena, fikuset etj.);
- Të kryejë punimin dhe plehërimin e tokës me plehra organike dhe minerale për mbjelljen e bimëve dekorative dhe aromatike;
- Të kryejë mbjelljen e bimëve zbukuruese në kopshtin e familjes si (gladiola, zymbyli, begonia, lulezjarri, tulipani, karafili etj.);
- Të kryejë mbjelljen e bimëve dekorative barishtore si (bari me pendë, xhingla, sesleria etj.);
- Të kryejë mbjelljen e bimëve zbukuruese shkurre dhe kacavjerrëse si (trëndafili, rozmarinë, jasemini etj.);
- Të mbjellë bimë aromatike në kopsht, sipas qëllimit të kultivimit (sherebelë, kamomil, trumëz, borzilok etj.);
- Të mirëmbajë kopshtet të zbukuruar me lule dhe hapësira të gjelbra;
- Të përgatisë buqeta me lule natyrale të stinës për klientë, në vazo dhe shporta;
- Të mbledhë dhe të thajë bimët aromatike të kultivuara në kushtet e kopshtit;

### **Të ushqyerit dhe kujdesi për kafshët**

- Të përzgjedhë llojin e ushqimit sipas nevojës së kafshës në regjimin stallor si: hasëlle, bar i thatë, gjethe dushku, silazh, koncentrat, etj.;
- Të përcaktojë territorin e duhur për kullotjen e lopëve, deleve ose dhive;
- Të ushqejë lopët në periudhën e laktacionit;
- Të ushqejë dhe kujdesen për viçat sipas grup moshave;
- Të ushqejë delet e dhitë gjatë periudhës së laktacionit;
- Të kujdeset për qengjat dhe kecat për pirjen e kulloshtres në sasinë dhe kohën e duhur;
- Të kryejë pastrimin, larjen, masazhin e gjirit si dhe mjelljen e dele dhe dhi sipas vakteve;
- Të ushqejë kalin që përdoret për transport dhe kalerim ;
- Të pastrojë kalin që përdoret për transport dhe hipizëm;
- Të ushqejë qentë dhe macen e shtëpisë;

### **Siguria ushqimore dhe higjiena në familje**

- Të zbatojë rregulloren e higjienës për punonjësit, mjetet dhe ambientet e bujtinës sipas kritereve të përcaktuara;

- Të kryejë lyerjen dhe pastrimin e banesës me mjetet përkatëse;
- Të mirëmbajë kutinë e ndihmës së shpejtë me mjete standarde (jod, garza, alkool, gërshëra etj.) si dhe bimët mjekësore të zonës sipas përdorimit të tyre;
- Të ruajë produktet bujqësore dhe blegtorale sipas standardeve;
- Të prodhojë lëngje dhe shurupe të ndryshme nga bimë të kultivuara dhe të natyrës spontane për pirje, sipas teknologjisë përkatëse;
- Të prodhojë reçelra, gliko etj. sipas teknikave të thjeshta;
- Të prodhojë produkte brumi të ndryshme në mënyrë artizanale;
- Të prodhojë vaj nga bimë vajore në mënyrë artizanale, sipas teknikave përkatëse;
- Të përpunojë perime (spec, domate, patëllxhan, kastravec, etj.) të ndryshme për prodhimin e turshive sipas traditës së zonës;
- Të prodhojë verë dhe raki në mënyrë artizanale nga rrushi apo bimë të tjera (man, kumbull, hurmë etj.) sipas teknikave përkatëse;
- Të përdorë veshje speciale për të ndërhyrë në zgjua për siguri nga pickimet;
- Të vjelë mjaltin në zgjua sipas rregullave të vjeljes;
- Të grumbullojë dhe ambalazhojë sipas standardeve mjaltin në enë të veçanta;
- Të përzgjedhë mjetet e nevojshme të punës për përpunimin e qumështit edhe në prani të turistëve sipas rregullave të sigurisë higjienike;
- Të kryejë pasterizimin e qumështit nëpërmjet trajtimit termik (zierjes);
- Të përpunojë qumështin për kos, gjizë, gjalpë dhe djathë sipas kushteve të fermës familjare;
- Të ambalazhojë produktet me bazë qumështi, sipas standardeve të ambalazhimit dhe ruajtjes;
- Të kryejë therjen pastrimin e shpendëve e kafshëve me mjete përkatëse;
- Të kryejë ndarjen anatomike të mishit sipas standardeve;

### **Sipërmarrja dhe organizimi**

- Të zbatojë procedurat e regjistrimit për hapjen e një kopshti familjar;
- Të organizojë shpërndarjen e punëve në ekonominë familjare sipas numrit, gjinisë, moshës dhe gjendjes shëndetësore të pjesëtarëve të familjes;
- Të planifikojë punimet ditore dhe periodike të rregullimit në ekonominë familjare;
- Të planifikojë shpenzimet që do të bëhen për prodhimet në kopsht, si dhe për plotësimin e nevojave të ndryshme familjare;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale të kopshtarisë;
- Të kryejë magazinimin e produkteve të kopshtit;
- Të përzgjedhë pajisjet paketuuese të përdorura në përputhje me kriteret e cilësisë;
- Të realizojë paketimin e prodhimit të produkteve të kopshtit;
- Të kryejë etiketimin dhe ambalazhimin e produkteve të kopshtit sipas standardeve;
- Të përgatisë produktin për konsum familjar, për turistët dhe për shitje;
- Të promovojë produktet e kopshtit;
- Të llogarisë kostot dhe çmimin e produkteve të ekonomisë familjare;
- Të përpilojë dhe plotësojë dokumentacionin financiar (faturë shit-blerjeje);

- Të kryejë tregtimin e produkteve të kopshtit;
- Të administrojë dokumentacionin e blerjeve dhe shitjeve;
- Të llogarisë të ardhurat, shpenzimet dhe rezultatin e ekonomisë familjare;
- Të plotësojë të dhënat për blerjet dhe shitjet duke përdorur programe kompjuterike;
- Të përdori Teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve me ferma të suksesshme me drejtim kopshtarie, vendase dhe të huaja;

### **Sigurimi teknik, mbrojtja e mjedisit**

- Të sigurojë dhe mbajë veshjen e përshtatshme për punët në kopshtari;
- Të kontrollojë gjendjen teknike të veglave dhe pajisjeve të punës;
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat, pajisjet dhe materialet e punës të kopshtarisë;
- Të zbatojë rregullat e përdorimit të pesticideve në aktivitetin e mbrojtjes së bimëve të mbjella në kopsht;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve shtëpiake dhe mjedisit;
- Të hedhë mbetjet dhe papastërtitë në vendet e përcaktuara;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë e të mbrojtjes së mjedisit gjatë kryerjes së punëve dhe shërbimeve në kopshtari;
- Të sigurojë mjetet e ndihmës së shpejtë dhe të japë ndihmën e shpejtë në rast nevojë;
- Të sigurojë shëndetin e familjarëve dhe pajisjen e tyre me librezë shëndetësore;
- Të zbatojë rregullat higjieno-sanitare në ekonominë familjare;
- Të marrë masat përkatëse për eliminimin e ndotjes;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me energjinë elektrike;

### **Legjislacioni në kopshtari**

- Të zbatojë aktet ligjore e normative, që rregullojnë veprimtarinë në kopshtari ;
- Të zbatojë aktet ligjore dhe normative në fuqi për prodhimtari dhe tregtim e produkteve në kopshtari ;
- Të kryejë procedurat e certifikimit dhe etiketimit të produkteve në kopshtari ;
- Të zbatojë normativat bazë ligjore për konkurrencën në treg për produktet në kopshtari ;
- Të zbatojë legjislacionin mbi kontratat e punës në kopshtari ;
- Të zbatojë elementet bazë të legjislacionit të pronësisë në kopshtari ;

## **KOMPETENCA TE PERGJITHSHME**

### **Individi duhet të jetë i aftë:**

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënies së tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij;